



REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I KONKURRENCËS

NJOFTIM PËR MEDIAT

Mbi vizitën në Tiranë të kreut të UNCTAD për konkurrencën dhe mbrojtjen e konsumatorit

Në datat 29 janar – 1 shkurt 2014, vizitoi Tiranën Z. Hassan Qaqaya, kreu i divizionit për politikën e konkurrencës dhe mbrojtjen e konsumatorit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD). Kjo vizitë u krye në kuadër të një vlerësimi të kërkuar nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, mbi veprimtarinë e këtij institucioni nga ana e UNCTAD dhe vendeve anëtare të këtij institucioni të rëndësishëm ndërkombëtar.

Gjatë kësaj vizite Z. Qaqaya u takua me Komisionin e Konkurrencës, stafin e Autoritetit të Konkurrencës, për të diskutuar për këtë proces. Gjithashtu Z. Qaqaya dhe Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës, Znj. Lindita Milo, zhvilluan takime me Z. Ilir Meta, Kryetar i Kuvendit, Znj. Zineb Touimi-Benjelloun, Koordinatorë e Përhershme e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, Znj. Eralda Cani, Këshilltare e Kryeministrit për të drejtën publike, Znj. Floreta Luli-Faber, Drejtoreshë Ekzekutive, Dhoma Amerikane e Tregtisë, Blerina Raca, përfaqësuese e GIZ etj.

Gjatë procesit të vlerësimit (Peer Review), ekspertët e pavarur të UNCTAD do të përgatisin një raport mbi përmirësimet e mundshme dhe mbi vlerësimin e nevojave të Autoritetit të Konkurrencës, për të kryer këto përmirësime. Ky raport, do të shërbejë si bazë për vlerësimin nga autoritetet përgjegjëse për konkurrencën të 192 vendeve anëtare të UNCTAD gjatë seancës vjetore të Grupit Ndërqeveritar të Ekspertëve (IGE) që do të zhvillohet në 2015 në Gjenevë.

Ky proces ofron një mundësi unike për të shqyrtuar dhe nxjerrë mësim nga përvojat dhe sfidat me të cilat përballen vendet e ndryshme në zbatimin e politikave të konkurrencës. Raportet e prodhuara gjatë procesit lidhur me gjendjen e ligjit të konkurrencës dhe zbatimin në vende të përfshira janë të paanshëm dhe rigorozë të kryera nga ekspertë të politikës së konkurrencës si nga vende të zhvilluara ashtu edhe në zhvillim të cilët kanë përvojë praktike në zbatimin e ligjit të konkurrencës .

Procesi i vlerësimit është interaktive dhe kombinon shkëmbimin e përvojave me rekomandime për përmirësime të mundshme qoftë në formulimin e ligjit të konkurrencës ose në zbatimin e tij. Më tej, ai ofron për vendet e interesuara në zhvillim asistencë teknike në rast se ata janë të gatshëm për të zbatuar rekomandimet përkatëse.

(Shih për më tepër <http://unctad.org/en/Pages/DITC/CompetitionLaw/Voluntary-Peer-Review-of-Competition-Law-and-Policy.aspx>)

Bio e Shkurtër e Z. Qaqaya

Hassan Qaqaya është kreu programit të Ligjit të Konkurrencës dhe Politikave të Konsumatorit të Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim (UNCTAD). Ai ka këshilluar vende të ndryshme në zhvillimin, formulimin dhe zbatimin e ligjeve kombëtare për mbrojtjen e konsumatorit dhe konkurrencës , ngritjen e institucioneve e kapaciteteve të konkurrencës dhe mbrojtjes së konsumatorit , ndërtimin institucional, trajnimin e trajnerëve për ligjzbatuesit e këtyre fushave dhe gjyqtarët. Ai ka një përvojë mbi 30 vjeçare në vende të ndryshme të botës në Evropë, Afrikë, Azi, Lindjen e Mesme, Amerikë Latine.